Kronikë

Kokainë, para e fishekë gjuetie, arrestohen 2 persona në doganën e Kakavijës. Tentuan të fusnin sende të paligjshme në Shqipëri

Dy persona janë arrestuar në pikën kufitare të Kakavijës teksa tentuan që të fusnin në Shqipëri, sasi kokaine, një shumë parash dhe fishekë.

Tedi Blushi

Redaksia
7 Nëntor, 15:45 | **Përditesimi: 7 Nëntor, 17:14**

Share

Dy persona janë arrestuar në pikën kufitare të Kakavijës teksa tentuan që të fusnin në Shqipëri, sasi kokaine, një shumë parash dhe fishekë.

Në pranga ka rënë 48-vjeçari me iniciale E. N., të cilit gjatë kontrollit fizik dhe atij të automjetit, u gjet dhe u sekuestrua një sasi lëndë narkotike kokainë, 2 celularë dhe 3700 euro. Mbi 48-vjeçarin rëndon akuza penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Gjithashtu u arrestua 49-vjeçari me iniciale I. Gj., ku në furgonin e tij u gjetën dhe u sekuestruan 10 kuti me fishekë gjuetie (në total 250 fishekë), të cilat ai nuk i kishte deklaruar konform ligjit dhe nuk ishte i pajisur me leje për transportimin e tyre. Mbi 49-vjeçarin rëndon akuza "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive".

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Gjendja financiare dhe sfidat e kryetarëve të rinj në 5 bashkitë që shkojnë në zgjedhje të dielën! Vlora shpenzimet më të larta, Cërriku i 'mbytur' në borxhe

"Kakavije/Vijojnë kontrollet intensive nga Policia Kufitare, për parandalimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale.

Goditen 2 raste të paligjshmërive në kufi.

Tentoi të hynte në Shqipëri, me lëndë narkotike kokainë në automjet, kapet nga shërbimet e Policisë Kufitare dhe arrestohet 48-vjeçari.

Tentoi të fuste fishek gjuetie, në Shqipëri, kapet nga shërbimet e Policisë Kufitare dhe procedohet penalisht 49-vjeçari.

Sekuestrohen lëndë narkotike kokainë, 3700 euro dhe 250 fishekë gjuetie.

Shërbimet e Policisë Kufitare Kakavije, në vijim të punës për goditjen e krimeve ndërkufitare, bazuar në analizën e riskut, kanë kaluar për kontroll në vijë të dytë, në hyrje të RSh-së, automjetet me drejtues shtetasit E. N. dhe I. Gj..

-Gjatë kontrollit në automjetin e shtetasit E. N. dhe kontrollit fizik ndaj tij, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan një sasi lëndë të dyshuar narkotike kokainë, 2 celularë dhe 3700 euro.

Gjatë kontrollit në furgonin me drejtues shtetasin I. Gj., shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan 10 kuti me fishekë gjuetie (në total 250 fishekë), të cilat ai nuk i kishte deklaruar konform ligjit dhe nuk ishte i pajisur me leje për transportimin e tyre.

Në përfundim të veprimeve për këto raste:

-specialistët për Hetimin e Narkotikëve të DVP Gjirokastër arrestuan në flagrancë shtetasin E. N., 48 vjeç, banues në Berat, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve";

-specialistët për Hetimin e Krimeve të DVKM Gjirokastër referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin I. Gj., 49 vjeç, banues në Patos, për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", thuhet në njoftimin e policisë.

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: kokaine Gjirokaster

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni skemën e re të rritjes së pensioneve?

6 Nëntor, 09:44

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e kuptoj

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Lajme të tjera

Merr flakë automjeti në tunelin e Skërfcës, shpëton pa lëndime drejtuesi
5 Nëntor, 22:37

VKM/ Ndryshime ne prefekturën e Shkodrës dhe të Gjirokastrës, largohen nga detyra Odise Kote dhe Majlinda Angoni, ja zëvendësuesit
5 Nëntor, 17:38

Shiste kanabis dhe kokainë në doza, pranga 25 vjeçarit në Tiranë
5 Nëntor, 13:38

Tepelenë/ Kërcënoi me armë gjahu të riun, arrestohet 19-vjeçari
5 Nëntor, 13:33

Gjirokastër/ Dyshohet se abuzoi seksualisht me një të mitur, pranga 24-vjeçarit
5 Nëntor, 13:27

Gjirokastër/ Armë dhe drogë në banesë, në pranga 57-vjeçari, djali i tij i mitur dhe një tjetër! Edhe 2 persona në kërkim
5 Nëntor, 11:10

Shiste kokainë në Lushnjë, arrestohet 32-vjeçari! Aktivitetin kriminal e kamuflonte duke udhëtuar si punëtor sezonal në vendet fqinje (EMRI+VIDEO)
5 Nëntor, 09:51

Tepelenë/ Kërcënuan me armë gjahu të riun, shpallet në kërkim 19-vjeçari! Nis hetimi për një tjetër
2 Nëntor, 14:22

Kakavijë/ Tentuan të fusin mallra kontrabandë, arrestohet një nga shoferët e autobusit të linjës Athinë-Tiranë, nis hetimi për tjetrin
1 Nëntor, 13:20

Emrat/ U kapën duke transportuar emigrantë të paligjshëm nga Nepali, arrestohet dy rinjtë nga Tirana në Gjirokastër
1 Nëntor, 11:48



Lezhë/ Policia i gjen kokainë dhe kanabis në makinë, arrestohen dy të rinjtë dhe nis hetimi për adoleshentin (Emrat)
1 Nëntor, 11:16

U kap me 10 kg kokainë të fshehur në bagazhin e makinës, arrestohet i riu shqiptar në Itali
1 Nëntor, 10:28

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje